



Ftesë

Ftohen gratë e interesuara të marrin pjesë në Sesionin Informues të organizuar nga CARE, për Skemen e Granteve për Gratë në sektorin e bujqësisë.

Sesioni informues do të mbahet me datë: **02.06.2023 duke filluar në ora 10:30, në sallën e Pallatit të Kulturës në Gjakovë.**

CARE International Balkans, zyra në Kosovë, në bashkëpunim me CARE Austria po zbaton Projektin Fuqizimi Ekonomik i Grave në Zonat Rurale të Kosovës-WEERA, financuar nga Austrian Development Cooperation-ADC. Veprimi që do të zbatohet nga CARE, do të kontribuojë në një zhvillim më të barabartë dhe gjithëpërfshirës socio-ekonomik në zonat rurale të Kosovës dhe do të rrisë përfshirjen ekonomike dhe sociale të grave rurale të Kosovës duke përmirësuar konkurrencën e bizneseve të tyre dhe kapacitetin e tyre të pjesëmarrjes qytetare.

Projekti pritet të kontribuojë në rezultatet e mëposhtme:

1. Bizneset rurale të udhëhequra nga gratë janë të pajisura për të prezantuar zgjidhje të qëndrueshme financiare dhe mjedisore dhe për të përmirësuar pozicionin e tyre në treg, nëpërmjet një skeme financiare dhe asistencës teknike.
2. Gratë nga zonat rurale janë të vetëdijshme për të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale dhe pajisen me kapacitete dhe mundësi për pjesëmarrje aktive në proceset vendimmarrëse lokale.
3. Njohja e gjerë e rolit të grave në zonat rurale të Kosovës përmes promovimit të praktikave më të mira të projektit dhe tregimeve të suksesit.

Ky program është një mundësi unike për gratë në bujqësi për të ngritur kapacitetet e tyre prodhuese dhe përpunuese dhe ka një qasje të orientuar nga tregu që vjen si rrjedhojë e kërkesave të tregut dhe të trendeve globale.